



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 65-dh paragrafi (1) i Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR METODOLOGJINË E
IDENTIFIKIMIT TË BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMORE
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.
102/22)

1. Në vendimin për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistmore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17 dhe ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21), pika 8) ndryshon si më poshtë:

"Krahas qasjes sasiore nga kreu II i këtij vendimi, Banka Popullore mund të zbatojë edhe vlerësim cilësor mbikëqyrës në bazë të të cilit:

- banka, vlerësimi përmbledhës i së cilës është nën pikën kufitare, mund të identifikohet si bankë me rëndësi sistmore;
- banka e klasifikuar në nënkategori me rëndësi sistmore, në pajtim me pikën 6), paragrafi (1), të këtij vendimi, mund të klasifikohet në një nënkategori më të ulët ose më të lartë me rëndësi sistmore."

2. Titulli i kreut V ndryshon si më poshtë: **"PËRCAKTIMI I SHITESËS MBROJTËSE TËKAPITALIT NË BAZË TË VLERËSIMIT CILËSOR MBIKËQYRËS".**

3. Pika 9), ndryshon si më poshtë:

"Në rastet e zbatimit të vlerësimit cilësor mbikëqyrës nga kreu IV i këtij vendimi:

- banka nga pika 8), paragrafi (1), nënparagrafi 1) të këtij vendimi, klasifikohet në nënkategorinë më të ulët të rëndësisë sistmore, të përcaktuar në pajtim me kreun III të këtij vendimi;
- banka nga pika 8) paragrafi (1), nënparagrafi 2) të këtij vendimi, klasifikohet në nënkategorinë përkatëse më të ulët ose më të lartë me rëndësi sistmore, të përcaktuar nga zbatimi i vlerësimit cilësor mbikëqyrës".

4. Në pikën 10), paragrafi (2), pas fjalëve: "mirëmban bankën", shtohen fjalët "sipas qasjes sasiore dhe sipas vlerësimit cilësor mbikëqyrës".

5. Në pikën 12), paragrafi (2), fjalët: "pika 8) e këtij vendimi" zëvendësohen me fjalët: "pika 8), paragrafi (1), nënparagrafi 1) të këtij vendimi".

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/VII-3/2022
26 prill 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska